

**VENDIM**  
**Nr.116, datë 7.3.2007**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE SLOVENE,**  
**PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e kalimit transit të 11 (njëmbëdhjetë) trupave dhe 4 (katër) mjeteve ushtarake slovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë–Durrës–Qafë-Thanë, në datën 14 mars 2007.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit kufitar, Qafë-Thanë.

Pika e daljes të jetë pika e kalimit kufitar në Durrës dhe pika e kalimit kufitar, Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Gjatë itinerarit të lëvizjes, trupat slovene të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**